

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr 1156/prot
R

Gramsh, më 27/03/2020

Vendim
Nr. 25, dt. 26.03.2020

Për

Për shpërndarjen e bonusit të qirasë për disa familje në nevojë ,bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh .

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 26 03.2020, pasi mori në shqyrtim relacionin e drejtorisë së shërbimeve ,” Për shpërndarjen e bonusit të qirasë për disa familje në nevojë ,bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh _në mbështetje të ligjit nr.22/2018,datë 03.05.2018 “Për strehimin social”,në VKM nr.459,datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirsë ose uzufuktit,mënyrën e financimit të subvencionit,monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin”,në Udhëzimin e MFE,nr.31,dt.18.11.2019,”Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimim e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit,të shkresës së MFE nr. 5462,datë 12.03.2020,”Transferim fondesh për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” të ligjit nr.139/2015,datë 17.12.2015,”Për vetëqeverisjen vendore”,neni 8,pika 2;

V e n d o s i :

- I. Të miratohet shpërndarja e fondit për shumën 1 971 925 lekë për 63 familje në nevojë për bonus të qirasë ,bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë,drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjencave civile,drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konc.E.Mema
Miratoi:G.Lena
Dosja nr. _____
Afati _____

Sekretari i Këshillit të Bashkisë
Endri MEMA



Kryetari i Këshillit të Bashkisë
Greta LENA

